Në detaje Orientimi hapsinor i ngastrës ku zhvillohen veprimtaria e lartë cekur është dhe në Kopje e planit me koordinata –skica nga drejtorija gjeodete kadastrale e Komunë së Glllogocit si dhe përshkrimi i kompletuar në fletën poseduese për numrin e ngastrës emertimin dhe pronarin e ngastrës.,

Shkritorja NeWCo FERRONIKELI Complex L.L.C gjendet në Drenas. Drenasi ndodhet 20 kilometra larg Prishtinës në perëndim, 24 kilometra në jug të Mitrovicës.

Fabrika shtrihet në një sipërfaqe të rrafshët me një pjerrësi të vogël nga veri-lindja drejt jug-perëndimit, prej 620 deri 590 m. Në fund të pjerrësisë ndodhet lumi Drenica, me rrjedhë drejt lindjes me 1 km nga kufiri jugor i zonës, në nivel prej 570 m.

Nga pikëpamja mjedisore kompleksi ekzistues mund të ndahet në 3 entitete:

- o Fabrika: ndodhet në një zonë industriale prej 81 ha. Qyteti Drenas ndodhet 1,3 kilometra në jug-perëndim larg shkritores.
- o Deponia e skories në Sukë ndodhet 500 m nga kufiri lindor i fabrikës. Hapësira e saj është rreth 32 ha. Skoria e deponuar në këtë deponi përmban rreth 3 milionë ton skorie në formë granulash nga e kaluara;
- o Pajisjet për ujë: këto mjete (pajisje) e mbledhin ujin nga hidrosistemi Ibër-Lepenc (17 km në veri-lindje të fabrikës). Këto mjete ndihmëse kanë një sipërfaqe prej rreth 1.2 ha.

Përreth fabrikës janë gjetur kryesisht sedimente të serpentinit nga Permotrias dhe sedimentet e sipërme janë Pliocene dhe periudha Kuaternare.

- o Serpentina: Këto serpentina janë gurët më të vjetër nga fusha e hulumtimit dhe janë të rëndë për xehet silikate të Ni-Co. Këto serpentina mbulojnë një sipërfaqe të madhe. Ato kanë një ngjyrë të kuqe të mbyllët dhe struktura e tyre e brendshme paraqet depërtimin e ajrit në pore;
- o Sedimentet pliocene paraqiten me argjilë, ranishtë dhe fundërrina prej rëre dhe mbulojnë hapësirën më të madhe të fushës hulumtuese. Fundërrinat më të fundit (Kuaternare) janë nga shtresat e sjella (aluviale) të formuara në luginën e Drenicës. Ato janë të formuara nga zhavorri i sjellë (aluvial) dhe rërës. Fuqia e tyre gjeologjike ndryshon prej 2 deri 8 metra.

Në zonën lokale (Kamenicë dhe Sukë) mund të gjendet guri gëlqeror si prej mermeri. Në zonën e Gradicës janë gjetur gurë gëlqeror me rërë dhe konglomerat. Në figurën 1 është paraqitur vendndodhja e fabrikës së Ferronikelit me rrethinë.

Lokalitetit është i lidhur me qendren komunale në një distancë rrugore afërsisht 2km.

7.0. PËRSHKRIMI I MASAVA TË PARAPARA PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGLIMIN E NDIKIMIT TË MUNDSHËM NË MJEDIS NGA PROJEKTI I PROPOZUAR PRA PËR PËRDORIMIN E MATERIALIT RDF NË FURRAT RROTULLUESE PËR PËRFITIMIN E FERRONIKELIT & IMPIANTIN E LARTË CEKUR.

7.1. MISIONET DHE KONTROLLA E TYRE – MONITORIMI & RAPORTIMI KONTROLLI I EMISIONEVE GJATË PROCESIT

Efekti kryesor në ambientin (mjedis) gjatë procesit teknologjik nga veprimtariaj që zhvillohet në NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,është emisioni në ajër që ne kapituajt e me sipërfaqe kemi përshkruar mënyrën e monitorimit të emisionit në ajër, ujë dhe në tokë, gjithashtu shfaqja e pluhurit si rezultat i aktiviteteve të transportit me dampër dhe temperaturave të larta në shumicën e rasteve është e menagjuar me masta preventive të parapara për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit të mundshëm në mjedis nga projekti i propozuar pra për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese për përfitimin e ferronikelit & impiantit të lartë cekur.

Po ashtu misioni dhe kontrolla duhet të fokusohet në objekt brenda dhe jashtë saj ku kemi sasi të emisionit të ndotjes akustike që është nën përqëndrimin maksimal të lejuar dhe her pas here rritet përqëndrimi i pluhurit sidomos në temperatura të larta pluhurit me sasi të vogël.

Sasia e pluhurit varet nga përmbajtja e lagështisë në rrëzë dhe zhavorit dhe lendenve diegje të cilat e sidomos linjiti është në hapësirat e hapura dhe si e tillë mund të monitorohet. Në rast të përkeqësimit të motit gjatë sezonit të thatë, është dukshëm pak më i rritur përqëndrimi i pluhurit deri në stabilizimin e faktorëve meteorologjik.

Gjatë sezonit të thatë rekomandohet spërkatje e rrugëve me ujë, pastaj pastrimi manual në hapësirat, si dhe pastrimi gjeneral me angazhim shtesë të fuqisë punëtore.

7.2. PROGRAMI I MONITORIMIT

Ndikimi i vetëm direkt nga aktiviteti i prodhimit bazuar me vlerësimet e ndikimit në mjedis është relativisht minimal në ambientin e mjedisit krahasuar me gjendjen e rehabilituar pas shfrytëzimit të ngastrës dhe si e

tillë pas përdorimit për nevoja ndërtimore degradimi eliminohet dhe peizazhi merr formën në harmoni me peizazhin për rrethë, Planin Hapësinor komunal dhe arkiteturen vendore.

Sipas ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 30 pika 2 “Personi fizik apo ligjor-juridik i cili hulumton apo prodhon apo merret me veprimtari të tjera ose që kryen aktivitete tjera të cilat degradojnë shtresën prodhuese ose shkaktojnë erozion të tokës apo ndryshim në regjimin e ujit “, duhet të restauroi sipërfaqen e dheut, regjimin e më hershem ujorë dhe stabilitetin gjeomekanik, në vazhdimsi e sidmos nëse ndrohet destinimi i veprimtaris së lartë cekur .

Ky restaurim duhet të kryhet gjatë operimit dhe pas përfundimit të aktiviteteve në pajtim me mbrojtjen e aprovuar mjedisore dhe planit lokal te veprimit ne mjedis ne kuader te infrastrukturës dhe urbanizmit të komunës së Glllogocit .

7.3. .Karakteristikat Seizmike të terrenit

Seizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vete për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit. Në Impiantin: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,Fabrika për prodhimin e Ferronikelit. Sipas hartave seizmike, hapësira e gjerë e hulumtuar i takon intensiteteve me periudha të ndryshme reversibile që do të paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela 2. Intensiteti seizmik i regjionit të hulumtuar të shkallës MSK-64	
Periudha kthyes (vjet)	Shkalla e seizmitetit
50	VI dhe VII
100	VII, VIII dhe IX
200	VIII dhe IX
500	VIII dhe IX
1.000	VIII dhe IX
10.000	VIII dhe IX

Sipas tabelës 2 për periudhën kthyesë prej 500 viteve, kompleksi përkatës gjendet në zonën e shkallës VIII të MSK-64 të intensitetit seizmik, kështu që koeficienti i seizmitetit duhet zgjedhur me vlerë $K_6 = 0.05$.

sipas kriterëve seizmike vetë Seizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vetë për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit. Gjithashtu faktori i stabiliteti seizmik të terrenit gjithnjë duhet të merret në konsiderim nga projektante e ndërtimeve qoftë edhe objektet e ndërtimit duke filluar nga depoja e depozitimeve të prodhimeve e deri në ndërtimet më të larta

7.4. STABILITETI I TERRENIT

Në pikëpamje të stabilitetit regjioni i hulumtuar konkretisht; Objekti i Fabrikës së lartë cekur e në kuadër të: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, Seizmiteti i terrenit paraqet parametër me interes në vetë për analizën e ndikimeve të mundshme në fushën studimore të mjedisit . Vlen të theksohet se : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,

bënë pjesë në kategorinë e terreneve relativisht stabile. Kështu që në këtë pikëpamje nuk ka karakteristika që do të ishin të çfarëdo interesi për analiza të ndikimit në mjedis në ngastrën kuështë cekur në fletën poseduese dhe kopjen e planit ku gjendet Impianti i Ferronikelit , përveq Objekteve konstruktive gjatë ndërtimit duhet të e ken në konsiderim kriterin seizmik për rritjen e qendrueshmëris dhe mënyrën e ankerimit me armatur dhe hekur të çeliku në kuptim të testimit të materialit ndërtimor . Oborreve(shesheve, parqeve etj.) .

7.5. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Kur jepen karakteristikat pedologjike mund të përfundohet se në regjionin e gjerë më e përhapur është toka relativisht ranore-argjilore dhe alevritore . Sipërfaqet për rreth janë relativisht banuara me kalimin gradual ete pa diktuar nga një lokacion apo fshat në tjetrin. Në bazë të kësaj del se kjo tokë është e dedikuar për kullorë dhe drithërat apo kulturat bujqesore një vjeqare dhe ishte për rreth tokë rentabile, mirpo trojet më pranë rrugës tani janë të destinuara për veprimtari të biznesit individual qoftë në aspektin e përkohshëm apo të përhershëm. Lagështia higroskopike është mesatare në bazamnetin dhe në argjilën si përbërje pedologjike .

7.6. Karakteristikat hidrografike

Në lokacionin kuështë ndërtuar objekti Fabrikës së : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, me Objektet përcjellëse për zhvillimin e veprimtarisë së lartëcekur në Objektin: Impiantin ***Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në kuadër të SHPK***: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, karakterizohet me atë se në afërsi të ngushtë nuk gjendet rrjedhe lumore, mirpo ajo zonë në përgjithsi është e pasur me ujëra nëntoksore dhe në përgjithsi janë të përfshira edhe me ujësjellsin publik, ndonëse mbrenda : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,, hapja e galerive sipërfaqësore travrbankut dhe përdhesave për vendosjen e bunkereve për xehe dhe për lëndet diegse , janë para qitur ujërat nëntokësore në mënyr të vazhdueshme dhe ajo sai e ujrave mund të përdoret edhe për mirmbajtjen e fabrikës, shenbull ne temeperaturat e larta sperkatja e terrenit si dhe rikutivimi i fidaneve dhe vegjetacionit qe absorboin pluhurin dhe dioksidin e karbonit, perveq rëndësisë që kanë për peisazh dhe pastrimin e ajrit lirimin e Oksigjenit nga veprimtaria e lartë cekur nuk hynee bë procesin teknologjik uji . Ndonëse në përgjithsi është i përfshire sistemi publik i ujësjellsit për uji të pijes nga Iber Lepenci .

7.7. Karakteristikat klimaterike

Regjioni i shqyrtuar në këtë elaborat –Raportin e VNM, karakterizohet me klimë kontinentale, e cila është karakteristike për tërë Kosovën. Karakteristikat e kësaj klime do t’i paraqesim në vijim. Ndikimi I Mikroklimës në mjedis për arsye të ndikimit të Fabrikës së Ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, mund të ketë ndikim që mund të monitorohet dhe është nënmenaxhimin dhe kontrollin ndotës mbrenda ekipit përkatës si njësi e Kompanisë së Ferronikelit

7.8. Temperatura e ajrit

Të dhënat mbi ndryshimet e temperaturës paraqesin bazë të karakteristikave klimaterike për regionin e analizuar.

Temperaturat mesatare vjetore rriten njëtrajtësisht nga janari deri në korrik e pastaj ulen. Muaji më i ftohëtshëm janari me temperaturë më të ulët mesatare të shënuar afër -15 gradë celsius, kurse më i nxehtë korriku me temperaturë më të lartë mesatare të shënuar rreth 37 gradë celsius.

7.9. Lagështia e ajrit

Lagështia relative e ajrit oscilon gjatë vitit dhe është në raport të kundërt me temperaturat e ajrit. Të dhënat tregojnë vlerë mesatare vjetore rreth 77%. Lagështia më e ulët është në muajin prill, kurse më e lartë në dhjetor.

7.10. Flora dhe Fauna

Ndikimi i procesi të punës që do të kryhet tek “: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, si Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit duke e përgatitur dhe ferguar xehen e ferronikelit ne furrat rrotulluese njikohesisht duke e përdorur edhe materialin RDF për energji termike në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,- .në florë dhe faunë paraqet një dukuri që duhet të shqyrtohet në kuptim të evidentimit të pasojave të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm. Rritjen e vegjetacionit , rikultivimin e fidaneve gjete gjere , dhe fidaneve Halore , për arsye se ujërat nentokësore janë të para qitur brenda Objektit të Fabrikës së lartë përmendur dhe në mënyrë të vazhdueshem largohet me pompa ujërat nëntokësore për të mos I vërshuar Objekte përcjellëse përdhese të Fabrikë së ferronikelit , uji I pompuar gjithnje mund të përdoret për rikultivim dhe ritjen e vegjetacionit dhe ruajtjen e mikroklimës . Përderisa Fauna është pak caë zhvendosur në viset malore për rrethë

Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut. Në vendin ku është bërë procesi i ndërtimit dhe vazhdon aktiviteti punues i lartëshënuar në lokalitetin e ngushtë të vendndodhjes veprimtarisë

Pra mundë të themi se në regjionin e ngushtë dominojnë bimët barishtore të rralla janë ato drunore si druri i shëlgut e bagremit dhe shëljës plepit etj. Bazuar në vërtetimin vizuel nuk haset ndonjë llojë endemikë apo i mbrojtur me ligj. Mirëpo në rrethinën e zonës ku realizohet projekti në bazë të vërtetimeve vizuale kemi hasur në bimësi të ulëta barishtore dhe kultura periodike bujqësore, por në një largësi evidente nga lokacioni në fjalë.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me funksionimin veprimtarisë së lartëcekur në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, ,, pasi që në parim edhe zënë një sipërfaqe relativisht të madhe .

Në bazë të të dhënave të Agjencionit të Mjedisit nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe të natyrës në përgjithësi apo të ndonjë territori-zone që parashihet të futet nën mbrojtje. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit, e duke e marrë për bazë edhe të dhënat nga vendësit, në këtë zonë mund të jetojnë Fauna shtëpijake e akomoduar në mbikqyrje të familjeve dhe personave privat me vullnet të mire, po ashtu edhe insekte të ndryshme dhe lloje të shpezëve shtëpijake etj.

Mirëpo në lokacionin kuështë vendosur Objekti i Fabrikës së lartë cekur me veprimtarinë e lartë cekur do të kemi largim të botës shtazore për shkak të aktivitetit punues.

8. KARAKTERISTIKAT E PEIZAZHIT

Karakteristikat e peizazhit të hapësirës së analizuar paraqesin njërin nga elementet për të saktësuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin kompleksi i Objekti i Fabrikës së lartë cekur e në mbrojtjeje e mjedisit. Karakteristikë është se këtu kemi të bëjmë me një peizazh të larmishëm, rural. Bimësia mesatarisht e zhvilluar. Hasen shtëpitë për banim të ndërtimit të ulët. Peizazhin e lartshënuar idilik e krijon vetë relievi dhe bimësia. Nga e tërë kjo mund të themi se peizazhi ka efektin e vetë pozitiv në psikikën e njeriut. Në peizazh ndikojnë morfologjia e terrenit, vegjetacioni, sipërfaqet ujore, qielli; të cilat janë karakteristika fizike natyrore, kurse ato të krijuara janë ndërtimet e bëra për rreth Objektit: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në kuader të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C tani e ka në prioritet rregullimin e peizazhit për arsye të hapësirës së mjaftueshme dhe sasisë së ujërave nëntokësore të mjaftueshme

8.1. INFRASTRUKTURA EKZISTUESE

Objekti kryesorë me objektet përcjellëse për zhvillimin e veprimtarisë së lartëcekur në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,. Është përshkruar edhe në orientimin hapësiror të Fabrikës së Ferronikelit Në Lokaliteti i lartcekur ku është ndërtuar objekti kryesorë me objektet përcjellëse për zhvillimin e veprimtarisë në Objektin: Fabrika : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,.. posedon infrastrukturë të mirë në kuptimin e plotë të infrastrukturës bashkëkohore.

Lokacioni posedon rrjetë të kanalizimit, të ujësjellësit, rrjetë elektrik , ndërsa menaxhimi i ujërave sipërfaqësore që krijohen gjatë të reshurave atmosferike ujërat shkarkues në të ardhmen duhet të rregullohet e që është në rrugë e sipër në këtë rast investitori ka ndërtuar një grop septike për tërë truallin apo Oborrin Ekonomik e që është i drenazhuar komplet dhe për platon në formë të izoluar nga ujërat nëntoksore pranë së cilës është e ndërtuar edhe një grop septike e izoluar dhe për inertet të sjellura me uji që nuk tretet . Prandaj, ky rekomandim ndaj investitorit nga hartuesi e elaboratit të VNM, që kjo procedurë duhet të rregullohet me qëllim që ujërat nëntokësore mos të ekspozohen ndotjes. Pra, një rekomandim i bëhet investitorit të kompanisë në fjalë që rreth e përqark lokalitetit të ndërtojë sistemin e drenazhimit që do të shkojnë në Gropen septike dhe me rritjen e kapaciteteve Grumbulluese është e planifikuar edhe ndërtimi i teknologjisë neutralizuese të shkarkimeve të ujërave nga Oborri ekonomik i : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,- e më pastaj do të shkojnë në rrjetin e kanalizimit ekzistues apo të futet në përdorim për ujitjen dhe pastrimin në Objektin: Fabrika për prodhimin e e

Ferronikelit. Për spërkatje të gjelbërimit për freskim dhe zvoglimin e Pluhurit , që të njejtën gjë e ka të paraqitur në projektin tekniko investiv investitori.

8.2. VLERËSIMI I TËRËSISHËM I GJENDJES SË MJEDISIT DHE RREZIKUT

Analiza e gjendjes ekzistuese të mjedisit në rrethinën e Objekti i Fabrikës së lartë cekur e kuështë ndërtuar objekti kryesorë me objektet përcjellëse për zhvillimin e veprimtarisë së lartëcekur në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, në Komunën e Glllogoci -(Drenasi)t, pa përfshirë ndikimet e mundshme të shkaktuara nga vetë Objekti i Fabrikës së lartë cekur si ndikime të pa përfillshme dhe shumë të vogla, tregon se në kuadër të hapësirës së analizuar ndikimet mund të vijnë kryesisht nga aktiviteti i punës së komplekseve tjera dhe Objekti i Fabrikës së lartë cekurve tjera edhe me kapacitet edhe me te larta.

Analizat e gjendjes ekzistuese në lëmin e ekosistemit, florës, faunës dhe karakteristikat e peizazhit tregojnë se nuk bëhet fjalë për potenciale relevante. Nga kjo mund të konkludojmë se nuk ka ndonjë bazë për ekzistim të ndikimeve negative mbi përqëndrimin maksimal të lejuar. Gjatë vizitës që i bëmë lokacionit kuështë ngrit objekti kryesorë me objektet përcjellëse për zhvillimin e veprimtarisë së lartëcekur në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, me selinë e lartëpërmendur jep pasqyrë të ambientit të ruajtur nga ndotja.

8.3. KOMPONENTËT DALËSE NGA PROCESI TEKNOLOGJIK I PRODHIMIT TË FERRONIKELIT PËRMES FURRAVE RROTULLUESE DUKE E PËRDORUR MATERIALIN RDF SISITEM PËR ENERGJI TERMIKE PËR KOHË MË TË SHKURT DUKE E KONSIDERUAR SI ENERGJI EFICIENTE NË KUADËR TË : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,

Komponentët dalëse nga procesi teknologjik i lartë cekur mundë të jenë:

- Ujërat e ndotura nga te reshurat atmosferike që do të jenë nën kontroll dhe do të pastrohen nga investitori.
- Ndikimi në ajr emisioni në ajr është tërësisht i monitoruar dhe mbahet nën kontroll nën përqëndrimin maksimal të lejuar
- Zhurma që gjithnjë do të jetë nën normativat e lejuara në njësin decibel-db.

- Mbeturinat e inerteve skoriohet nga procesi i prodhimit që mund të largohen me kohë .
- Mbrojtja e tokës në të cilën është vendosur lokacioni me drenazhimin e ujit nga Oborri ekonomik dhe ndërtimi i gropës septike-Sistemi i tratimit të ujerave në kuadër të Kompleksit të Ferronikelit në pikën ku bëhet prurja e ujit gjatë të reshurave.

8.4. UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI

Nevojat për ujë të pijshëm sigurohen nga rrjeti i ujësjellësit ndërsa uji teknik për zbutjen e sperkatjes së oborrit në temperaturë të lartë për qëllime të ndryshme që i kemi cekur më lartë janë të mjaftueshme ujërat nëntokësore që edhe ashtu pompohen nxjerrjen nga boejkti perdhës në pjesën ku janë të vendosura shiritat transportues , gjithashtu ujërat nën presion mund të përdoren edhe kundërzjarrit nga pusi –bunari pra konsiderohet ujërat nëntokësore që në vazhdimsi pompohen për të i larguar nga objektet perdhese të Fabrikës së lartë cekur në kuadër të: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, për brenda oborrit ekonomik të Fabrikës së Ferronikelit apo Kompleksit të FE-Ni në tërësi të: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C“. Shkarkimi i ujërave nga kompleksi do të realizohet pasi të kalon në sistemin e trajtimit të ujerave që tani veq është në funksion në Imipiantin e lartë cekur.

8.5. Rezultatet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rezultatet e analizës tonë rreth vlerësimit të detalizuar të ndikimit në mjedis nga secili aktivitet i lartcekura i punës në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, në fjalë, bazuar në aspektet e lartpërmendura i kemi prezentuar në tabelat në vijim.

Shqetësimi i komunitetit dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, si aspekte mjedisore, nuk janë përfshirë në rezultatet e vlerësimit të ndikimit në mjedis, për arsye se nuk ka asnjë ndikim nga aktiviteti i Objekti i Fabrikës së lartë cekur në : Gjeomonumentet, trashëgimin kulturore dhe religjioze, monumente shtetërore , si dhe Objektet me rëndësi të veçantë të evidentuara në të dhënat e arkeologjike dhe në listën e objekteve me rëndësi të veçantë pra në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në tërësi haspirën që i përket Fabrikës së lartë cekur në fjalë nuk ka asnjë dëmtim, shkatërrimin e trashëgimisë kulturore , gjeomonumenteve, relikteve apo repereve poligonike gjeodezike, apo edhe simbole fetare e religjioze , relikteve arkeologjike etj, në kuadër të “: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,

9.0. MASAT E MBROJTJES SË MJEDISIT

Në bazë të dokumentacionit në disponim: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,si investitor për në planifikimin e përdorimit të materialit RDF në furrat rrotulluese për përfitimin e Ferronikelit , në fjalë me veprimtarinë e lartëcekur si aktivitet primarë si dhe në bazë të vrojtimit të vetë lokacionit, autori i elaboratit mjedisorë raportiti të VNM për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese , përfaqësuesi i N.SH. Gjeomjedisi Mr.inxh.dipl. Vehbi Goxhuli- konstaton se me dokumentacionin në disponim, puna ne terren gjatë hartimin te raportiti te VNM, si bazuar në projektin e arkitekturës dhe ndërtimtarisë dhe monitorimit të gjendjes faktike në terren apo në këtë në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,. Janë të realizuara shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.

9.1. MASAT MBROJTËSE TË UJËRAVE SIPËRFAQËSORE

Aktualisht: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C“,- është në përgatitjen së dokumentacionit që i nevojitet për inicimin e procesit të punës pëlqimit mjedisor për përdorimine materialit RDF si fituar nga riciklimi mekanik dhe biologjik i mbeturinave urbane nga sistemi i perfitimit te komponnetes RDF i cila mund të ketë impakt mjedisor, mrpo nga analizat laboratorike te materialit RDF qe planifikohet të përdoret mundë të menaxhohet,kontrollohet në aspektin e Impaktit mjedisor ka të bëjë me materialin që ka kaluar ne sistemin RDF gjate riciklimit mekanik dhe biologjik me material te mbetjeve urbane jo të rrezikshem sipas kodeve shtetore të identifikaur si në përmeldhejn ekzekutive ne fillim te raportit të VNM për materialin RDF qe esht planifikuar të përdoret në Furrat rrotulluese për përfitimin e Ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, si Kompleks në tërësi mundë të gjenerojë ndotje të ujërave sipërfaqësorë por investitori ka paraparë në projektin teknik edhe eksizton sistemi per trajtimin e ujerave siperfaqesore ne teresi, qe nga fillimi qe zhvillon veprimtarin Komplkesi i FE-Ni . Pra, mundësia për ndotje të ujërave sipërfaqësore nga Objekti i Fabrikës së lartë cekur në Objektin: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,) i lartshënuar mund të ekzistojë deri sa nuk bëhet trajtimi i ujërave të grumbulluara nga oborri ekomik prodhues nga Impianti i lartë cekur . Pra, nga kjo kuptojmë se, nëse pronari nuk i përmbahet rregullave mjedisore atëherë do të ketë edhe gjenerim të ndotjes së ujërave në tokë.

9.2. Programi i Monitorimit të Ndikimit në Mjedis

Investitori i Objekti i Fabrikës së lartë cekur në Objektin: Fabrika për prodhimin e ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, në fjalë me veprimtarinë e lartë cekur në kuadër të Impiantiti apo Kompleksit të Ferronikelit , duhet të bëjë monitorimin e vazhdueshëm të ndikimit në mjedis gjatë operimit të Objekti i Fabrikës së lartë cekur duke bërë matjet e: Zhurmës, Pluhurin në ajër ndonëse me përqëndrim të pluhurit , dhe Analizimin e ujërave shkarkues., ndotjet difuzive, matjen e rrezatimit , dejonizimit , emisioni ne Ajër , Uji dhe toke , fillimisht për studmi të brendshëm për të i monitoruar, raportuar dhe menaxhuar nga stafi profesioonal përkatës në kuadër të Kompleksit te : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,

9.3. Masat Rehabilituese pas Ndërprerjes së Aktivitetit të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C të disa njësive punuese

Në rast të përfundimit të aktivitetit të ndonji objektit percejales të Objektit tei Fabrikës së lartë cekur në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit , në fjalë me veprimtarinë e lartë cekur ,duhet të bëhet largimi i shtresave të betonuara në hapësirën ku është ndërtuar Objekti i Fabrikës së lartë cekur me objektet percjellese ne kuader te Komplkesit te FE-NI , pra për kthimin e tokës ne gjendje të mëparshme që ka qenë para se të fillonte aktiviteti dhe që të jetë ë përshtatshme për tu planifikuar sipas planit lokal teveprimit ne mjedis sipas planit zhvillimor komunal apo nw pjeset me periferike edhe kultivimin e të lashtave bujqësore, gjithashtu edhe mihjet siperfaqësore për rrethë nëse mbesin të eksploatuara, gjithsesi ato duhet te rinovohen e te mirmbahet apo të implemetohet pastaj edhe në ate ngastër plani lokal i veprimit në mjedis sipas planit urbanisitk të komunës së Gllogocit Pronari i : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,Objekti i Fabrikës së lartë cekur në lokacionin e lartcekur në Komunën e Gllogoci -(Drenasi)t,është i obliguar që pas mbarimit të shfrytëzimit të kësaj parcele të kthej në gjendje të pranueshme hapësirën e shfrytëzuar. Kultivimi i këtyre sipërfaqeve të shfrytëzuara përfshinë rivitalizimin në tërsi të hapësirave të dëmtuara nga Veprimtaria qe esht zhvilluar- realizimi i projektit.

9.4. NATYRA DHE BIODIVERSITETI

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës , nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit ne kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi .

9.5 NDIKIMET NË VENDBANIME DHE POPULLATË

Zhvillimi i veprimtarisë së lartë cekurë në Objektiv: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit në kuadër të :
“NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,

Ndikon pozitivishtë pasi që ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rajoni sepse do të punësoj një numër të caktuar të punëtorëve. Nga faktet e lartë cekura mund të konkludojmë se në aspektin social dhe ekonomik konsiderohet si veprimtari e shumë e dobishme , krahas mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi nga Veprimtaria prodhuese e lartë cekur , si dhe shërbimet që ju bëjnë qytetarëve në infrastrukturë : krijohen mekanizmat të bashkpunimit në sektorin publik dhe privat.

10.0. KONKLuzionet dhe Përmbledhja Ekzekutive

Pas punimit të këtij raporti të VNM , mund të konkludohet se : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “,. me destinim në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit , konkretisht kompleksi i ferronikelit ne komunën e Glllogocit me rrethinë edhe gjatë përdorimit të materialit RDF si aditiv apo material shtesë për rritjen e shpejtë të temperaturës në furnat rrotulluese për përfitim të Ferronikelit për përfitimin e produktit final, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë , ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë elaborat të VNM, konstatohet se ato mund të minimizohen në nivel të dukshëm, edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë sanimit dhe monitorimit të vazhdueshëm krahas zhvillimit të aktiviteteve për prodhimin e ferronikelit në kuadër të “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C .Unë Mr.inxh.dipl.Vehbi Goxhuli gjatë hartimit të raportit të VNM për përdorimin e materialit RDF në furnat rrotulluese për prodhimin e ferronikelit dhe vizita në terren dhe konsultimin e vazhdueshëm me personelin përkatës të ferronikelit për mbrojtjen e mjedisit konstatoi: se nuk e dëmton mjedisin (tokën, ajrin, ujin dhe resurset natyrore) mbi përqëndrimin maksimal të lejuar sipas parametrave reprezentativ të analizave fiziko kimike dhe bakteriologjike dhe analizave tjeëra të emisionit në mjedis , pra në fazën e tanishme, duke u bazuar në faktet në terren dhe konsulta me aplikuesin e “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C, njëherit mund të kontrollohet e menaxhohet impakti mjedisor nga Kompleksi i Ferronikelit , për të mos patur implikime mjedisore , pra nuk ndikon negativisht në resurset natyrore dhe njerëzore, dhe i plotson kushtet apo është teknologji me e avansuar që aplikohet tani në Ferronikel pra me paisje dhe lende diegse me ekologjike me efikasitet të konsideruar edhe si material që gjeneron energji termike eficiente . Po ashtu si lokacion adaptuar akomoduar për Kompleksin e ferronikelit në kuadër të : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C Ndikimi i Fabrikës së lartë cekur në kuadër të “: “Kompleksit të Ferronikelit apo impakti në Mjedis, është në nivelin e vlerave të rekomanduara nga Ligjin për Mbrojtjen në Mjedis-LMMK . Ndikimi në ambientin tokësor është i vogël, kurse ndikimi në ajër mund të menaxhohet të kontrollohet mirmbahet dhe njëherit nuk e tejkalon normativat e lejuara mjedisore kurse në ujë mund të monitorohet e mbahet nën kontroll dhe të kontrollohet në perioda të caktuara edhe për studim të brendshëm në kuadër të sistemit të trajtimit të ujit që disponon Kompleksi Ferronikel që nga fillimi i veprimtarisë së lartë cekur në këtë Impiant. Për të dy këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të çdo viti kalendarik, dhe sipas kërkesës së Ministrisë.

- Ka hapsirë të mjaftueshme për të ushtruar këtë veprimtari, dhe ka mundsi reale për infrastruktur të mirfillt .
- Në plotësimin e kriterëve të mjedisit dhe për një ambient të qëndrueshëm investitori apo pronari i ka të parapara të gjitha masat e poshtëshënuara, por detyrohet që t’i përmbahet këtyre masave në vijim:
- o Të kete vazhdimsi për të marrë masat për mbledhjen e ujërave nga e tëra hapësirat e lokacionit të Objekti i Fabrikës së lartë cekur të Te vazhdon të bëhet drenazhimi dhe akumulimi i tyre para se të shkarkohen në recipient apo efluent si dhe ujërave nga të reshurat atmosferike sepse njëkohësisht nga të reshurat bëhet edhe shpërlarja e oborrit ekonomik të Fabrikës për prodhimin e ferronikelit në kuadër të “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, atyre shoqërues sipas rregullores të parapara me ligjin e mjedisit.
- Gjatë punës normale të Objekti i Fabrikës së lartë cekur në : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, duhen respektuar të gjitha masat mbrojtëse rregullativa ligjore në fuqi për të cilat pronari është i informuar edhe për këtë pothuajse ka përgatitur tërë dokumentacionin dhe terrenin ku zhvillohet puna.
- Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në në Objektin: “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, në fjalë të cilat ndikojnë në mjedisin jetësor dhe duke i zbatuar të gjitha masat e përmendura nga kjo analizë e bërë dhe duke pasur parasysh kapacitetin e : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, dhe mjedisin rrethues të lokacionit mund të konkludojmë se veprimtaria e Kompleksit të Ferronikelit . nuk shkakton ndikime negative në mjedis dhe nuk rrezikon shëndetin e njeriut dhe në pikëpamje të mbrojtjes së mjedisit mendojmë se mund të i lëshohet pëlqimi mjedisor nga MMPH sipas kërkesës të kompanisë : “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C “, për përdorimin e materialit RDF të furrat rrotulluese për prodhimin e ferronikelit . ”. Mendojmë se kjo;
- Aplikacioni-kërkesa do të aprovohet pasi që investitori i kompanisë posedon tërë dokumentacionin që kërkohet nga autoritet vendore.
- E konstruktuar dhe e paisur me (infrastruktur përcjellëse dhe komplete që mundëson zhvillimin e veprimtarisë me efikasitet të lartë). Në të cilin elaboratë të kompletuar të VNM është përfshirë përveq tjerash edhe incizimi i vendëndodhjes së Lokacionit të cekur, marrja e koordinatave sipas Kosovarefit, si dhe përshkrimi i detajuar i funksionimit dhe i paisjeve të domosdoshme për ti plotsuar kriteret sipas dispozitave të miratuara nga DMMU në kuadër të MMPH dhe legjislacionit të fundit nga MMPH dhe standarteve të Bashkësis Evropine dhe Organizates Botrore të Shëndetësis.

11.0. PËRFUNDIM

Në në Objektin: Fabrika për prodhimin e Ferronikelit ne Kompleksin e Ferronikelit, në kuadër të “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C“, nuk ka emitim të substancave të rrezikshme në ajër, ujë dhe tokë më potencial të rëndësishëm për rrezikim të shëndetit dhe të mjedisit nëse zbatohen të gjitha masat mbrojtëse të cilat janë rekomanduar në këtë Raport të VNM për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese për përfitimin e Ferronikelit. Elaborati i hartuar i VNM është dokument me rëndësi për të plotësuar aplikacionin për të aplikuar për Pëlqim mjedisor në DMMU sektori I VNM në kuadër të MMPH.

Gjatë punës normale në Kompleksin e Ferronikelit : Ferronikeli prodhon një ferroaliazh unik - ferronikelin (FeNi). Xehja e hekur-nikelit ,furnizohet nga minierat lokale (Gllavica dhe Çikatova), si dhe xehja nga shtetet tjera duhen të respektuar të gjitha masat mbrojtëse dhe rregullativa ligjore në fuqi.

Bazuar në studimet mjedisore të terren dhe bazuar në analiza dhe statistika e të dhënave mjedisore rrjedhimisht është ardhur në përfundim se puna e Objektivit të Fabrikës në lartë cekur , Në vend ndodhjen e Objektivit të Fabrikës “NEWO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C“, në Objektin e Fabrikës së Ferronikelit (Kompleksi Fe-Ni) nuk shkakton degradim në zonë, nuk ka objekte me vlerë arkeologjike.

Ndërsa sipërfaqja e ku është vendosur Impianti-objekti i Fabrikës së lartë cekur dhe eksploatimi Vendburim të ferronikelit Fe-Ni pas përfundimit të aktiviteti prodhues dhe procesit teknologjik është i planifikuar projekti ideor. Sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi të legjislacionit vendor i nënshtrohet rehabilitimit dhe kthimit në tokë antropologjike siq ka qenë para zhvillimit të aktivitetit biznesor.

HARTUESI I RAPORTIT PËR VNM:
PËRDORIMIN E MATERIALIT **RDF** NË FURRAT RROTULLUESE TË
NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C ; është

N.SH. “Gjeomjedisi” VEHBI GOXHULI – Mr.sc.inxh.dipl




E-mail:gjeomjedisi@hotmail.com; vehbigoxhuli@gmail.com

Tel: +383/ 044/330322 dhe 049/380301

